

Komuna e Dragashit: problemet kryesore dhe trendët buxhetor

Hyrje

1. Komuna e Dragashit qeveriset nga koalicioni PDK-VAKAT, ku kryetari i Komunës vjen nga radhët e PDK, sikurse edhe njëri nga nënkryetarët dhe kryetari i Kuvendit Komunal. Komuna e Dragashit ka 33.997 banorë¹ dhe përbëhet nga 36 fshatra që i përkasin dy etnive të ndryshme: shqiptarë dhe goran.
2. Kryetar i Komunës është Salim Jenuzi. Ky është mandati i dytë për Z. Jenuzi, pas rizgjedhjes së tij në zgjedhjet e fundit lokale më 2009. Mandati i tij i parë përfshinë periudhën 2007-2009. Para tij Komuna e Dragashit është udhëhequr nga Halim Shemsedini (LDK), i cili ka qenë në krye të komunës që nga paslufta.
3. Komuna e Dragashit shtrihet në pjesën jugore të Kosovës dhe kap një territor prej 435 km katror. Kjo komunë ka një lartësi relativisht të madhe mbidetare, që sillet prej 700-2550 metra mbi nivelin e detit, gjë që bën që dimrat në këtë komunë të jenë të gjatë kurse verat të shkurta dhe të freskëta. Reshjet e shumta të borës përveç që shkaktojnë vështirësi në komunikacion, kanë sjellë edhe ortekë dëbore, sikurse ai i Restelicës. Dragashi kufizohet edhe me Shqipërinë dhe me Maqedoninë.
4. Sipas një hulumtimi të UNDP, qytetarët e Komunës së Dragashit kanë radhitur papunësinë si problemin më të madh (60% e të anketuarve e konsiderojnë atë problemin numër një). Në listën e shqetësimeve kryesore për qytetarët e kësaj komune radhitet edhe furnizimi i dobët i ujit (12% e të anketuarve e kanë renditur atë si problemin kryesor), pastaj infrastruktura e dobët rrugore (8% e të anketuarve).²

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Rezultatet nga Regjistrimi i Popullsisë dhe Amvisive 2011

² UNDP. Mozaiku i Kosovës 2012. Fq.27.

Problemet kryesore të Komunës së Dragashit

1. Niveli i ulët i pjesëmarrjes së femrave në arsim dhe punësim.

Ndonëse papunësia konsiderohet si problem nacional, në komunat më periferike të Kosovës ky problem është edhe më i thellë. Në Dragash vetëm 5% e femrave janë të punësuara, kurse rreth 90% e femrave janë jashtë tregut të punës.³ Niveli i ulët i punësimit të femrave ndërlidhet edhe me shkallën e arsimimit të tyre, ku femrat e moshës së rritur kanë nivel shumë më të ulët arsimor se sa meshkujt. Vetëm 15% e femrave kanë përfunduar shkollimin e mesëm, kurse vetëm 2% kanë një diplomë universitare.⁴ Sidomos në zonat më rurale, qasja e femrave në shkollim është edhe më e vështirë.

Një faktor që dekurajon vijimin e shkollimit të mesëm është distanca e largët nga objekti shkollor. Dragashi ka vetëm një gjimnaz i cili shërben për nxënësit e të gjithë fshatrave të kësaj komune. Transporti i nxënësve nga fshatrat për në Dragash është i vështirë dhe i kushtueshëm. Nxënësit duhet vet të mbulojnë shpenzimet e udhëtimit pasi se Komuna nuk ka paraqitur ndonjë plan për bartjen e nxënësve nga fshatrat e largëta për në gjimnaz. Sa i përket stimulimit për shkollim universitar, Komuna e Dragashit është ndër komunat e rralla të Kosovës që nuk ndan bursa për studentët e kësaj treve, ndonëse kjo komunë është më e largëta nga Universiteti i Prishtinës, ku kryesisht orientohen të rinjtë e saj.

Duke pas parasysh se vetëm 2% e femrave kanë diplomë të shkollimit universitar, Komuna do duhej të gjente alternativa të tjera për angazhimin, trajnimin dhe aftësimin e femrave të kësaj komune për tu angazhuar në ndërmarrësi apo në zanate të ndryshme përfituese. Po ashtu mbetet sfiduese stimulimi i vajzave për të vazhduar shkollimin e mesëm kur dihet se 85% e femrave nuk kanë vazhduar shkollimin pas shkollës fillore. Organizimi i bartjes së nxënësve për në Dragash mund të ishte faktor stimulues.

2. Dhuna në shkolla. Dhuna fizike në gjimnazin e Dragashit “Ruzhdi Berisha” ka qenë mjaft evidente viteve të fundit, ku si pasojë disa nxënës janë sulmuar me armë të ftohta. Pas përlëshjeve mes vete, në shumicën e rasteve nxënësit e përfshirë në konflikt janë sulmuar edhe nga të afërmit e palëve të përfshira. Gjatë këtij viti një nxënës është plagosur rëndë në oborrin e shkollës nga persona

³ Po aty.

⁴ Po aty.

nga jashtë, të cilit policia i kishte liruar menjëherë pas marrjes në pyetje, dhe të cili të nesërmen kishte kërcënuar me jetë edhe vet drejtorin e shkollës. Ky rast kishte nxitur banorët e Dragashit që të protestojnë para Komunës, Policisë dhe Gjykatës Komunale, duke shprehur pakënaqësinë e tyre me këto institucione përgjegjëse për sigurinë publike.

- 3. Sistemi paralel serb.** Komuna e Dragashit asnjëherë nuk ka arritur të integrojë të gjithë qytetarët e saj në sistemin e arsimit dhe administratës të Republikës së Kosovës. Sidomos në aspektin e arsimimit, në këtë komunë vazhdojnë të funksionojnë shkolla që punojnë me plan-programe të Serbisë, mësues që paguhen nga Serbia por që janë shkolla që mirëmbahen nga Komuna e Dragashit. Nga 39 shkollat e Komunës së Dragashit, 27 financohen nga institucionet e Kosovës, 9 financohen nga institucionet e Serbisë dhe 3 financohen pjesërisht nga Kosova dhe Serbia.⁵ Problemi me sistemin paralel serb nuk është mësimi në gjuhën serbe, por programi mësimor i cili është ndryshe nga ai kosovar, i cili përveç të tjerash nuk e njeh realiteti i ri kosovar dhe kështu vetëm sa vështirëson integrimin e komunitetit goran. Për më tepër, në fshatin Vraniq ndodhet edhe administrata paralele serbe e cila kryen shërbime administrative për qytetarët goran.
- 4. Furnizimi me ujë të pijshëm.** Hiq papunësinë si një problem tepër i madh, qytetarët e Dragashit problemin numër dy e konsiderojnë furnizimin me ujë të pijshëm. Pakënaqësia me ujë ka të bëjë edhe me mungesën e ujit dhe me cilësinë e ujit. Për një komunë me terren malor, që do duhej të kishte tepricë të ujit, mungesa e tij apo ndërprerjet e gjatë të ujit janë të papranueshme për banorët e kësaj komune. Rreth 29% e të anketuarve janë shprehur se kanë ndërprerje të furnizimit me ujë më të gjata se 11 orë në ditë.⁶ Ndërkaq shumë fshatra të kësaj komune ballafaqohen edhe me cilësinë aspak të mirë të ujit të pijes, ku në shumë raste në mungesë të ujit të pijes autoritetet lokale kanë futur lumin në rezervuarin e fshatit pa siguruar mekanizma të duhur filtrues⁷. Në vitin 2011 janë investuar gjithsej 381.443 euro për ujësjellës. Megjithatë kjo komunë ende ka problem me sasinë dhe cilësinë e ujit. Për më tepër, megjithëse uji është një resurs i fortë në Dragash, ai kryesisht përballet me ndotje organike. Andaj mbetet sfiduese se si të mbrohen resurset e ujit nga humbjet dhe nga ndotjet, si dhe si të përmirësohet kualiteti i ujit.

⁵ Draft Plani Zhvillimor Komunal për Komunën e Dragashit 2012-2022

⁶ UNDP. Mozaiku i Kosovës 2012. Fq.28

⁷ Në një gjendje të tillë ndodhet fshati Kuk, ku pas futjes së lumit në ujësjellësin e fshatit cilësia e ujit ka rënë dukshëm.

5. Mungesa e barnave dhe shërbimeve nëpër qendra spitalore.

Shumica e banorëve të Dragashit janë të pakënaqur me furnizimin me barna në institucionet shëndetësore që përfshinë Qendrën Kryesore për Mjekësi Familjare (QKMF), pesë qendra të mjekësisë familjare dhe tetë klinika shëndetësore. Përveç QKMF, e cila ofron shërbime 24 orë, ambulancat tjera punojnë me një ndërrim ose me dy ndërrime më së shumti. Kështu, ambulanca në Restelicë punon deri në ora 2 pasdite. Ambulanca e Bresanës punon me dy ndërrime. Në ambulancën e fshatit Kuk mjeku shkon rrallëherë. Ambulanca në Llapushnik ka mungesë të barërave esenciale.

6. Deponitë ilegale.

Edhe pse shumica e fshatrave të Dragashit janë në lidhur në sistemin e menaxhimit të mbeturinave, që kryhet nga “Ekorajoni”, megjithatë në disa fshatra janë krijuar deponi ilegale të cilat ndotin rëndë ambientin. Aktivistët e grupit “Ta pastrojmë Kosovës” kanë identifikuar rreth 20 deponi ilegale përgjatë rrugëve në drejtim të fshatit Zaplluxhe, Brod, Restelicë, Shajne, Bellobrad, Glloboqicë, etj. Periferia e fshatit Bellobrad, për shembull, është përplot mbeturina, edhe pse ky fshat është i lidhur me sistemin e menaxhimit të mbeturinave. Deponi të tilla përveç se ndotin ambientin mund të jenë edhe burim i infeksioneve të shumta, sidomos kur dihet se bagëtitë e këtyre fshatrave kullosin gjithandej. Komuna e Dragashit, të paktën deri më tani, nuk ka nxjerrë një rregullore për mbrojtjen e ambientit, e cila megjithatë është në procedurë të shqyrtimit nga ana e komunës⁸.

7. Mbështetja e klubeve sportive.

Komuna e Dragashit nuk ofron shumë aktivitete të sportit të organizuar. Duke qenë një komunë me terren shumë të përshtatshëm për sporte dimërore, komuna ka dështuar që të krijojë një ambient për ushtrimin e aktiviteteve sportive dimërore. Megjithëse ka pasur iniciative individuale të organizimit të garave të skijimit, Komuna nuk ka treguar gatishmëri për avancimin e këtij sporti. Edhe pse Komuna ka mbështetur projekte të vogla të garave sportive sikurse turnirët në futboll të vogël, garat e pehlivanëve, vrapimi i kuajve, etj., aktivitetet e tilla kanë qenë më shumë në baza ad-hoc. Komuna do duhej të kishte një projekt dhe strategji për stimulimin dhe avancimin e sportit në këtë komunë në baza më afatgjate. Kjo do të nënkuptonte ndërtimin e fushave të futbollit, ndërtimin e një palestre sportive, ndërtimin e fushave të skijimit, ri-aktivizimin e garës së mundjes e cila deri para luftës ka qenë garë me përmasa rajonale që është organizuar për çdo vit me 1 maj. Në përgjithësi, për pushtetet e deritanishme lokale sporti dhe turizmi kanë qenë dy fushat më të lëna anash.

⁸ Mehmeti Spahiu, *Dragashi me 20 deponi ilegale të mbeturinave*, Koha Ditore, 20 qershor 2013

8. Mungesa e transportit me Prizrenin dhe mospastrimi i rrugëve nga bora. Pasi që Dragashi është komuna më jugore e Kosovës, si qendër më të afërt zhvillimore kjo komunë ka qytetin e Prizrenit. Por, mungesa e shpeshtë e transportit me Prizren pamundëson lëvizjen e shpeshtë të qytetarëve të Dragashit dhe banorëve të Gorës. Qyteti i Dragashit është 37 kilometra larg Prizrenit, por transportit publik (autobusët) që lidhin këtë relacion janë shumë të rrallë. Autobusi për linjën Prizren-Dragash shkon vetëm dy herë në ditë, duke i bërë qytetarët që të presin me orë të tëra. Problem tjetër që haset gjatë dimrit është mospastrimi me kohë i rrugëve nga reshjet e borës. Duke qenë se kjo komunë ndodhet në një lartësi të madhe mbidetare, reshjet e shumta të borës shpesh bllokojnë qarkullimin e komunikacionit. Edhe pse Komuna për çdo vit angazhon kompani private për pastrimin e rrugëve, pastrimi i tyre bëhet me vonesë dhe jo në cilësinë më të mirë. Ky mos efikasitet vështirëson edhe qasjen e ndihmës së shpejtë në rast të goditjes nga ortekët e borës.

Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur

- 1. Vendet me potencial turistik.** Dragashi, me një lartësi relativisht të madhe mbi nivelin e detit, karakterizohet me një natyrë mjaft të bukur që mund të shërbente për zhvillimin e turizmit. Deri më sot nuk ka pasur ndonjë plan konkret për zhvillimin e turizmit malor. Vendeve me potencial turistik u mungon infrastruktura e duhur që do të nxiste investimet në ato pjesë. Megjithatë ka pasur iniciativa individuale për investime, të cilat pa një plan të koordinuar me Komunën veçse mund të shkatërronin ato pjesë turistike. Dragashi ofron një mori mundësish për zhvillimin e turizmit sikurse: ecjen në natyrë dhe kampimin, kalërimin dhe çiklizmin malor, skijimin dhe ecjen në borë, etj. Në mesin e aseteve të veçanta turistike të kësaj komunë hynë Parku Nacional i Sharrit, Mali Koritnik dhe zonat e thella malore ku turistët mund të shohin kafshë të egra si arinj, ujq, dhi, etj.
- 2. Llojlojshmëria e bimëve mjekuese dhe e frutave të malit.** Komuna e Dragashit është e pasur me një shumëllojshmëri të bimëve të cilat shfrytëzohen nga kompanitë farmaceutike. Në bjeshkët e kësaj komune rriten disa lloje të bimëve malore, e sidomos boronica dhe manaferra. Në vitet e fundit persona të pa ndërgjegjshëm ia kanë vënë zjarrin me qëllim bjeshkëve, duke djegur kështu me qindra hektarë ku rriteshin këto lloje të bimëve. Mbrojta e kësaj pasurie natyrore do duhej të ishte ndër prioritetet e Komunës sepse nga vjelja e tyre përfitojnë shumë familje të cilat më pas i shesin ato, si dhe në të kaluarën shumë grupe studimore kanë vizituar këto anë për të parë nga afër rritjen e bimëve të rralla natyrore.

3. Zona e biznesit. Në afërsi të qytezës së Dragashit Kuvendi Komunal ka shpallur një pjesë toke si zonë të biznesit. Ky vendim ka më shumë se katër vjet që është marrë. Megjithatë deri më tani vetëm dy kompani kanë ndërtuar objektet e tyre afariste. Njëra synon të prodhojë veshje sportive, kurse tjetra synon të merret me grumbullimin dhe përpunimin e frutave të malit. Shpallja e këtij trualli si zonë biznesi mund të nxitë prodhuesit privat në krijimin e bizneseve dhe hapjen e vendeve të punës. Megjithatë, Komuna nuk ka arritur të sigurojë infrastrukturën elementare si uji, kanalizimi e sidomos energjia elektrike. Mos intervenimi i Komunës mund të qojë drejt fundit të këtij projekti ambicioz.


Trendet Buxhetore në Komunën e Dragashit

Buxheti i Komunës së Dragashit ka pasur një rritje të lehtë përgjatë këtyre viteve. Në vitin 2010, buxheti total i Komunës ishte 4.5 milion euro, kurse buxheti për vitin 2013 është 5.8 milion euro. Edhe pse buxheti është rritur gjatë këtyre viteve, të hyrat vetanake kanë shënuar rënie të lehtë gjatë periudhës 2010-2012. Në vitin 2013 këto të hyra planifikohen të jenë 420 mijë euro apo 55 mijë euro më shumë se në vitin 2012. Një ndër rekomandimet kryesore të raportit të auditorit⁹ për vitin 2012 vendosja e një sistemi automatik të faturimit dhe marrja e masave për rritje të hyrave nga taksat e ndryshme. Në komunën e Dragashit¹⁰ janë të regjistruara 13.6 mijë prona ndërsa 66% (rreth 9 mijë prona) prej tyre janë pagues të rregullt të tatimit kurse 44% nuk paguajnë fare tatim. Numri i pronave të paregjistruara mendohet të jetë rreth 300. Grafikoni më poshtë paraqet trendin e ndarjeve buxhetore 2010-2013:

⁹ ZAP, Raporti i Auditimi mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Dragash për Vitin e Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 06 Gusht 2013, http://oag-rks.org/repository/docs/Dragash_Report_ALB_726334.pdf

¹⁰ Përgjigje e Komunës së Dragashit në kërkesën e Institutit GAP rreth numrit të pronave. 03 Shtator 2013


Figura1. Ndarjet Buxhetore 2010-2013



Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?dragash/2013#/~/~dragash>

jesa më e madhe e buxhetit dedikohet për paga. Siç mund të shihet edhe nga grafikoni numër 2, në vitin 2013 rreth 57% e buxhetit do të shpenzohet në paga dhe mëditje, kurse shpenzimet kapitale zënë 32% të shpenzimeve totale.

Figura 2. Buxheti 2013



Në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Dragashit, komuna planifikon të rrisë shpenzimet në të gjitha kategoritë. Investimet kapitale planifikohen të kenë rritjen më të madhe me rreth 220 mijë euro. Kjo rritje të planifikohet të financohet kryesisht nga rritja e grantit qeveritar për këtë komunë.

Tabela 1. Korniza Afatmesme e Buxhetit 2014-2016

Të hyrat	2014	2015	2016
Të hyrat totale	6.452.646	6.639.521	6.793.906
Të hyrat vetanake	441000	454.230	463.315
Grantet	6.011.646	6.185.219	6.330.592
Shpenzimet Totale	6.452.646	6.639.449	6.793.907
Pagat dhe Mëditjet	3.367.100	3.435.455	3.435.455
Mallrat dhe Shërbimet	549.513	576.988	576.988
Shpenzimet Komunale	127.000	149.536	149.536
Subvencionet dhe Transferet	35.000	37.000	37.000
Shpenzimet Kapitale	2.374.033	2.440.470	2.594.928

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe monitorim të fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulumtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Dragashit është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj.

Të gjeturat e GAP dhe BIRN janë krahasuar edhe me të dhënat e hulumtimeve më të mëdha që janë bërë viteve të fundit në nivel lokal, ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012).



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.